



Prishtinë, 12 tetor 2012
Kodi i ZRRE-së: V_466_2012_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 5 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 03/L-184);
- Propozimin e datës 27.08.2012 të bërë nga Operatori i Sistemit të Transmisionit (OST) të dokumentit Metodologjia për përgatitjen e Balancave të Energjisë Elektrike, për miratim dhe nxjerrje;

në seancën e mbajtur me datë 12 tetor 2012, nxori këtë:

VENDIM

I. MIRATOHET Metodologjia për përgatitjen e Balancave të Energjisë Elektrike.

Arsyetim

- Bazuar në dispozitat e Nenit 5 të Ligjit për Energjinë, Operatori i Sistemit të Transmisionit (OST) dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) duhet të konsultohen me Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) për përpilimin e dokumentit Metodologjia për përgatitjen e Balancave të Energjisë Elektrike.
- Sipas po të njëjtit Nen të Ligjit për Energjinë, Zyra e Rregullatorit për Energji nxjerr metodologjinë e miratuar që duhet zbatuar nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.
- KOSTT me datë 27.08.2012 ka prezantuar dokumentin në ZRRE për miratim, ndërsa pas komenteve të bëra nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), në bashkëpunim KOSTT-ZRRE është përgatitur versioni final i dokumentit për miratim dhe implementim.

II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bashkëngjitur dokumenti:

Metodologjia për përgatitjen e Balancave të Energjisë Elektrike.

Vendimi dërgohet te:

- Operatori i Sistemit të Transmisionit KOSTT Sh.A
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes KEK Sh.A
- Arkivi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar